

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vende pune për personel ndihmësakademik pranë Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave në pozicionin “Specialist i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ALUMNI dhe Karrierës”.

A. Kandidatët për personel ndihmësakademik në pozicionin “Specialist SBC, ALUMNI dhe Karrierës” pranë Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të zotërojnë diplomë universitare së paku në ciklin “Master Profesional” në një nga programet e studimit të Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave ose në një nga programet e studimit që ofron Universiteti Politeknik i Tiranës. Diplomë në programin e ciklit të dytë “Master i Shkencave” përbën përparësi.
2. Të njohin Kornizën Shqipëtare të Kualifikimit dhe të kenë njohuri për procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë në kuadër të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit;
3. Të kenë njohuri për programet e studimit që ofron Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave dhe të informojë nxënësit që kanë përfunduar studimet në ciklin e arsimit të mesëm për programet e studimit të ofron fakulteti, kriteret e pranimit, si dhe politikat e institucionit;
4. Të jenë në gjendje të këshillojnë studentët që diplomohen në një program të ciklit të parë mbi mundësinë e studimeve në një program të ciklit të dytë në FGJM, UPT apo universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit;
5. Të njohin tregun e punësimit të specialistëve që mbarojnë studimet në FGJM dhe të mbajnë lidhje të vazhdueshme me kompanitë e ndryshme brenda dhe jashtë vendit duke analizuar kërkesat e tyre;
6. Të mbajnë kontakte me ALUMNI-t, si dhe të mbajnë të dhënat e punësimit për studentët e diplomuar në FGJM;
7. Të kenë mbrojtur një gjuhë të huaj të Bashkimit Europian, gjuha angleze përbën përparësi;
8. Të njohin programet bazë të kompjuterit.

II. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik (Laborant) pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike në Departamentin e Kimisë.

A. Kandidatët për personel ndihmësakademik (Laborant) në Departamentin e Kimisë, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të kenë përfunduar studimet universitare në sistemin 3+2 (Bachelor dhe Master i Shkencave) apo diplomë të integruar të nivelit të dytë në Kimi/degët e saj;
2. Preferohen kandidatët që kanë eksperiencë pune në laborator;
3. Preferohen kandidatët që kanë njohuri të gjuhëve të huaja, preferohet gjuha angleze;
4. Kandidatët të kenë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **15.02.2023** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.